



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .02.2022

MBLEDHJA Nr. 06,
datë 14.02.2022, ora 12:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 14.02.2022, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 06 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 04.02.2022
2. Mbi shfuqizimin e pjesshëm të vendimit të bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.09.2020, mbi licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Sekë”, me kapacitet të instaluar 12667 kW dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kW, me kapacitet total të instaluar 14962 kW
3. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “HEC TERFOJA” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Tërfoje” me kapacitet të instaluar 1980 kW
4. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “HEC TERFOJA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
5. Mbi miratimin e rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit
6. Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2021
7. Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2022

8. Mbi shqyrtimin e kërkesës së OSSH sh.a. për ndryshimin e vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, “Për disa ndryshime në vendimin nr.104, datë 23.06.2016, të bordit të ERE, “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese, në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarrtshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE nr.49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013”
9. Informacion mbi verifikimin e zbatimit të afateve dhe procedurave për verifikimin e matësive në zbatim të rregullores “Mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.145, datë 18.09.2017 për aplikimet e regjistruara në OSSH gjatë muajit Dhjetor 2020 - Janar 2021
10. Informacion mbi monitorimin e kryer pranë shoqërisë FSHU sh.a. me qëllim marrjen në dijeni dhe masat e marra për zbatimin e detyrimeve që burojnë nga Plani i Masave për periudhën Janar – Shtator 2021
11. Çështje të tjera

Në zbatim të: (i) pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; (ii) Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”; (iii) Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; dhe (iv) Urdhërit nr. 19, datë 19.02.2021, “Për ndryshimin e pikës 1, të Urdhërit nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, për lejimin e pjesëmarrjes së palëve të treta, nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik, për sa i përket zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit, si dhe zhvillimin e seancave dëgjimore teknike apo publike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI